



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, dhe Vendimit Nr. 364, datë 29.5.2019 të Këshillit të Ministrave “Për Funkcionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, Urdhërit të Kryeministrit, nr. 137, datë 21.10.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore shpall konkursin për pozicionin:

**SPECIALIST NË SEKTORIN E SEKRETARISË TEKNIKE
KATEGORIA E PAGËS IV-2**

1. KUSHTET PËR KONKURIM DHE KRITERET E VEÇANTA:

1.1 Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurrim si vijon:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- f) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- g) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shtuar sipas këtij ligji.

1.2 Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Duhet të ketë arsimin e lartë me diplomë të Nivelit të Dytë të njohur nga Ministria e Arsimit të Shqipërisë, *në shkencat Inxhinierike/Ekonomike*.
- b) Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo "Master Profesional" të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, sipas fushës së diplomimit, (pika a).
- c) Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në fushën përkatëse të diplomimit, të vërtetuar me librezë pune/vërtetim nga punëdhënësi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE**

- d) Të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet, sipas fushës së diplomimit, si dhe studime pasuniversitare /kurse/trajnime të shoqëruara me certifikatë ose diplomë përkatëse.
- e) Të ketë aftësi për tu përshtatur me kushtet, teknologjinë dhe procedurat e reja të standardeve evropiane.
- f) Të zotërojë gjuhën angleze. Të ketë njohuri në gjuhë të tjera përbën avantazh.
- g) Të ketë aftësi praktike të të punuarit në kompjuter, në programe dhe softëare: Paketa Microsoft Window (Word, Exel, Power Point, etj).
- h) Të ketë aftësi të mira për: përshtatje pune në grup; të ketë aftësi të përmbushë detyrat brenda afateve të përcaktuara; aftësi komunikimi, referimi dhe mbrojtje të të dhënave, analizave, vendimeve, monitorimit dhe raportimit.

2. PËRSHKRIM PUNE “SPECIALIST NË SEKTORIN E SEKRETARISË TEKNIKE”:

Veprimtaria e Sektorit të Sekretarisë Teknike rregullohet në “*Rregulloren për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të saj*” miratuar me Urdhër të Ministrit të Kulturës.

Spektori i Sekretarisë Teknike ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Mban dhe administron dosjet/praktikat për vendimmarrje në KKTKM;
- b) Organizon mbledhjet e KT dhe KKTKM, bën njoftimin e pjesëmarrësve mbi rendin e ditës, përcjelljen e materialeve që do të shqyrtohen, etj.
- c) Njofton mbi çdo vendim të KKTKM dhe i dërgon për dijeni të gjithë palëve të përfshira në vendim dhe institucioneve për dijeni.
- d) Procedon me trajtimin e kërkesave nga subjektet dhe verifikimin e dokumentacionit përkatës të procedurave për dhënien, pezullimin, revokimin dhe kuotizacionin vjetor të licencave për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe për veprimtarinë arkeologjike, si dhe procedurave për dhënien, pezullimin, revokimin dhe kuotizacionin vjetor të licencave veprimtarine arkeologjike nënujore, të cilat janë propozuar me VKM të veçanta.
- e) Hartimi i vendimit/relacionit sipas vendimmarrjes së KT dhe KKTKM-së;
- f) Merr masa dhe siguron zbatimin e afateve dhe rregullave të caktuara sipas ligjit për shkëmbimin e korrespondencës;
- g) Merr masa dhe siguron një bashkëpunim të vazhdueshëm me sektorët e IKTK për çështje që do të diskutohen në mbledhjen e radhës së KT dhe KKTKM apo të tjera;
- h) Mban dhe përditëson:
 - 1. Regjistrin e vendimeve të KKTKM;
 - 2. Regjistrin publik të vlerave kulturore materiale;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE**

3. Regjistrin e subjekteve të licencuara për hartimin e projekteve dhe kryerjen e punimeve në pasuritë kulturore materiale;
4. Regjistrin kombëtar të lejeve për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale;
5. Regjistrin e ekspertëve vlerësues të pasurive kulturore të paluajtshme;
6. Regjistrin e subjekteve të licencuar në fushën e trashëgimisë arkeologjike;
7. Regjistrin kombëtar të lejeve për ndërhyrje në trashëgiminë arkeologjike;

Çdo detyrë tjetër të përcaktuar me ligj.

1. Zbaton të gjitha detyrat e ngarkuara nga Përgjegjësi i Sektorit në lidhje me përmbushjen e detyrave funksionale të sektorit, në zbatim të legjislacionit dhe akteve nënligjore për trashëgiminë kulturore.

3. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë;

- a) Jetëshkrim i aplikantit;
- b) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- c) Fotokopje të noterizuar diplomës;
- d) Fotokopje të noterizuar të listës së notave;
- e) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Vetë deklaram të gjendjes gjyqësore;
- h) Certifikata kualifikimi;
- i) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në protokollin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, **brenda datës 25.09.2024, ora 16:30.**

4. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit në datën **30.09.2024**, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, do të bëjë verifikimin paraparak të kandidatëve që plotësojnë kushtet për konkurrim, dhe do të shpallë në faqen e internetit të saj, listën e kandidatëve të kualifikuar që vazhdojnë konkurrimin, datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk janë shpallur të kualifikuar, do të njoftohen me email nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe kanë të drejtë të paraqiten pranë tij, për t'u njohur me arsyet e mos kualifikimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE**

Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

5. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA:

Kandidatët e kualifikuar për vazhdimin e konkurrimit, do të vlerësohen për:

- Njohuritë mbi:

- a) Ligji nr.76/2016, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- b) Ligjin Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe aktet ligjore dhe nënligjore të tij;
- c) Vendimin Nr. 364, datë 29.5.2019 të Këshillit të Ministrave “Për Funkcionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”;
- d) Kodin e Procedurave Administrative;
- e) Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- f) Legjislacionin për Kodin e Punës dhe rregullat e etikës në administratën publike.

6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore do ti njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në këndin e njoftimeve të publikuara pranë Institucionit.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në adresën elektronike info@iktk.gov.al.